



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 82
Prishtinë, më 24.4.2024, në orën 15:45
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Adelina Grainca, Yllza Hoti, Fitore Pacolli-Dalipi, Ariana Musliu-Shoshi dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Xhavit Haliti, Gazmend Gjyshinca, Doarsa Kica-Xhelili dhe Bahrim Shabani.

Të pranishëm në takim: Delegacioni i Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit të Republikës së Finlandës, në përbërje: Kimmo Kiljunen, kryetar dhe anëtarët e delegacionit: Tytti Tuppurainen, Sebastian Tynkkynen, Vilhelm Junnila, Jarmo Lindberg, Eva Biaudet, Jussi Saramo, Jonna Laurmaa -sekretare, Matti Nissinen Ambasador, Sanna Tavi e Sauli Therman.

Pjesëmarrës të tjerë: Adriana Osmani, Alisa Thaçi, Besarta Pllana, Blendi Gashi, Leudita Mejzini-Kuvend, Drin Podrimçaku,- GPLVV dhe Liridona Gashi -Kabineti i Kuvendit.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi Arbëreshë Kryeziu- Hyseni, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim i komisionit me Komisionin për Punë të Jashtme të Parlamentit të Republikës së Finlandës.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, theksoi se të dy vendet kanë marrëdhënie të shkëlqyeshme dhe se Finlanda ishte dhe është mbështetëse në proceset të cilat është duke kaluar vendi ynë sikurse edhe për anëtarësimin në KiE, gjë për të cilën u falënderua. Kosova tani pret votimin më 16 maj në KiE , e po ashtu, theksoi se jemi të njoftuar se BE-ja është duke u përgatitur për të hequr masat ndaj Kosovës, largimin e të cilave e ka kërkuar edhe Finlanda. Sa i përket dialogut me Serbinë, tha se situata e sigurisë mbetet e ndjeshme dhe se duhet të jemi konstruktivë që t'i shmangemi tensioneve dhe e eskalimit. Serbët, tha se janë bërë destruktiv dhe bllokojnë proceset të cilat synojnë normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve.

Znj. Kryeziu Hyseni përgëzoi Finlandën që është bërë anëtare e NATO-s, si gjë shumë të rëndësishme për të dhe për tërë rajonin dhe BE-në. Anëtarësimi i ynë në NATO, tha se është shumë i rëndësishëm,

sepse nëse Kosova kërcënohet, do të thotë që tërë rajoni dhe BP-ja është duke u kërcënuar, prandaj ne synojmë anëtarësimin e plotë në NATO dhe Partneritetin për Paqe. Ajo kërkoi nga delegacioni finlandez që të ndihmojnë Kosovën që t'i bashkohet NATO-s sa më parë.

Kimmo Kiljunen, theksoi se është kënaqësi e madhe të vijë në Kosovë. Prezantoi delegacionin dhe njoftoi se ishte njëri ndër deputetët shtytës për votimin e Kosovës në KiE dhe shpreson që deri në fund të vitit të kemi flamurin e Kosovës në Strasburg, ku qytetarët e Kosovës do të kenë qasjen në Konventën dhe Gjykatën për të Drejtat e Njeriut. Ai tha, se Finlanda është e zëshme për të avokuar dhe lobuar për Kosovën. Çështja e anëtarësimit të Kosovës në KiE është një hap përpara për integrim në organizata ndërkombëtare. Për tu anëtarësuar në KiE, tha se nevojiten disa kushte dhe njoftoi se e dinë se është bërë përparim në sundimin e ligjit, në demokraci dhe të drejtat e njeriut dhe pakicat që janë çështje shumë serioze dhe duhet t'i respektojmë dhe mbrojmë ato. Z. Kiljunen tha, se e dimë se ka tensione në mes të Serbisë e Kosovës në rajon, ata i kanë shkelur disa rregulla dhe shpresojmë se mund t'i tejkaloni këto çështje dhe të gjeni zgjidhje. Finlanda tha, se është vendi i cili e mbështetë perspektivën evropiane edhe për kosovarët.

Fitore Pacolli-Dalipi, theksoi se i vije mirë që sërish takon disa deputetë të cilët i kishte takuar gjatë vizitës në Finlandë. Bëri të ditur se Kosova po kalon në disa procese të rëndësishme, e posaçërisht anëtarësimi në KiE është shumë i rëndësishëm, për çka shpreson se çdo gjë do të shkojë mirë dhe nuk do të kërkohen parakushte të reja nga vendet tjera, siç është asociacioni, pasi që këto parakushte do ta dëmtojnë vet Serbinë. Kosova është mirë të pranohet në KiE dhe të kërkohet zbatimi i marrëveshjes me Serbinë në tërësi, e jo të zgjedhet për zbatim çka na pëlqen nga ajo marrëveshje. Kosova dhe Serbia duhet të detyrohen ta zbatojnë marrëveshjen dhe nuk duhet vënë parakushte për Kosovën, pasi ka hapa të duhur në sundimin e ligjit, demokraci dhe në luftimin e krimit të organizuar e korrupsionit. Ajo vuri në pah se PE-ja ka diskutuar për të njohur pasaportat ilegale për serbët lokalë që jetojnë në Kosovë, pasi që ne kemi bindur serbët vendorë për të aplikuar për pasaporta kosovare. Shumë nga serbet që jetojnë në Kosovë kanë aplikuar për pasaporta të Kosovës dhe mund të udhëtojnë pa viza. Duke u njohur këto pasaporta ilegale serbëve, tha se rrezikohet tërë procesi i integritit. Finlanda është mirë që të ngre zërin për këtë çështje sepse e kemi Planin e Ahtisarit, i cili e ka dizajnuar Kosovën në mënyrë që një shoqëri multietnike të jetojë së bashku, e jo të formohen kanale të tjera që të dëmtohet procesi i integritit. Ne dëshirojmë që serbët të integrohen dhe të kenë pasaporta legale të Kosovës, e jo dokumente ilegale që i ka lëshuar Serbia gjatë viteve të kaluara.

Kimmo Kiljunen, theksoi se pakicat kanë të drejta, por kjo nuk do të thotë që mund të kenë dokumente të paligjshme për të udhëtuar sepse është një faktor përçarës. Ai tha, se pajtohet plotësisht me parafolësen se kjo nuk do të mund të ishte gjëja e duhur e vendim i mirë. Beri të ditur se nuk ndodh shpesh që Parlamenti e Këshilli të mos pajtohen, por ndoshta do të mund të kemi ndikim dhe të shohim se çka mund të ndodh në këtë rast.

Ariana Musliu-Shoshi, theksoi se është kënaqësi që kemi delegacionin në takim me të cilët, tha se është takuar disa herë në KiE. Falënderoi delegacionin për lobimin për të cilin tha, se është zëri ynë atje, dhe u jemi shumë mirënjohës. Ajo tha, se e kemi një sfidë para takimit të Këshillit Ministror më 16 maj, përderisa jemi duke i parë deklaratat zyrtare nga vendet e Quintit që asociacioni mund të jetë një parakusht për anëtarësimin e Kosovës në KiE. Kjo, tha se nuk është gjë e drejtë sepse ne i kemi përmbushur të gjitha kushtet në sundimin e ligjit, demokraci, të drejtat e pakicave e ato njerëzore, kushte të cilat vendet e tjera nuk kanë pasur nevojë t'i përmbushin. Ne mendojmë se kushtet kryesore të cilat janë vendosur nga KiE i kemi përmbushur si vend dhe do të vlerësojmë nëse pranohen si të tilla, ashtu siç është cekur në raportin e Dora Bakoyannis dhe raportin e anëtarëve të Komisionit ligjor. Është edhe një letër e cila është dërguar nga Kryeministri e ministrja e jashtme, në të cilën përkushtohen

se do ta zbatojnë asociacionin pasi të bëhen anëtarë me të drejta të plota në KiE dhe ka një përkushtim që të kalojë edhe Kodi Civil, e çështje të tjera që janë ngritur nga ekspertë ligjorë dhe znj. Bakoyannis. Ne kemi pasur kompromise të mëdha për vendimin e Manastirit të Deçanit dhe tani të kemi edhe një parakusht tjetër që kërkon komuniteti ndërkombëtar, përderisa për Kosovën do të duhej një kohë shumë e gjatë të vij përsëri deri tek kjo pikë ku qëndrojmë tani. Sa i përket të drejtave të komunitetit joshumicë, z. Kervan ka prezantuar në KiE situatën faktike dhe reale të tyre. Serbët duhet të kenë një prezantim të denjë, e jo të kenë vetëm një parti e cila është drejtuar dhe dirigjuar nga Vuçiqi, që nuk mund të jetë prezantim i serbëve që jetojnë në Kosovë. Serbet, tha se i kanë 10 vende të rezervuara në Parlament nga 120 gjithsej dhe nuk ka vend tjetër evropian me një popullsi nën 5% që i kanë 10 ulëse të rezervuara për përfaqësim në Parlament, dhe nuk vijnë në Parlament dhe në komisione parlamentare.

Kimmo Kiljunen, njoftoi se delegacioni e ka vizituar veriun e Mitrovicës sot dhe serbët jo vetëm se kanë 10 vende të rezervuara në Parlament dhe nuk janë duke i shfrytëzuar të drejtat e tyre legjitime, por edhe nuk kanë dal në zgjedhjet e organizuara për të votuar, gjë që nuk kemi parë askund një gjë të tillë. Nëse nuk i shfrytëzojnë instrumentet politike që janë në dispozicion në një vend demokratik, siç është Kosova, pyeti e si mund të adresohen këto çështje?

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, theksoi se nuk është se ne nuk kemi një dialog normal me qytetarët serbë që jetojnë në Kosovë, pasi që e kemi një raport me ta. Nuk ka normalizime me serbët që jetojnë në pjesën veriore sepse kërcënohen gjithmonë nga Vuçiqi. Me serbët që jetojnë në Kosovë, tha se kemi dialog por nuk bëhen publike, pasi që ata mund të kërcënohen, prandaj i kursejmë nga pasiguritë e rreziqet e mundshme, nëse ata dalin në publik.

Mbledhja përfundoi në orën 16:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu- Hyseni,

Kryetare e Komisionit